



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUSHAJ  
ADRESA rruga Vaso Pasha, pallati 13/1  
Tirane  
TEL: 0692097547

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1861

Nr. koleksioni: 830

Tirane më 10/09/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 8 fletë



A2020053540068061252



## KONTRATË SHITJE AKSONESH (ME REZERVE)

Sot, më datë 10.08.2020, përpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

### PALA SHITËSE:

1. Shpëtim Liçaj, atësia Zihni, amësia Sanie, shtetas Shqiptar, lindur në Mollaj, Fier, Shqipëri (ALB) dhe banues në Tiranë, me adresë ismail qemali; Nd. 1814; H. 0; Ap. 007; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 25/09/1959, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034803775 dhe nr. personal F90225237E, .
2. Samir Canaj, atësia Qazim, amësia Behije, shtetas Shqiptar, lindur në Gruemire, Shkoder, Shqipëri (ALB) dhe banues në SHKODËR, me adresë BALSHAJ 03310455; Nd. 11; H. 14; Ap. 1; SHKODËR; SHKODËR; 4001; SHKODËR, lindur më 02/03/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033780955 dhe nr. personal G30302132C, .
3. Edjon Hila, atësia Zef, amësia Domenika, shtetas Shqiptar, lindur në Barbullush, Shkodër, Shqipëri (ALB) dhe banues në Vaudejës, me adresë Bri Mali; Nd. Nder.60; ; ; Bushat; Barbullush; 0000; Vaudejës, lindur më 09/01/1988, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032324141 dhe nr. personal I80109078Q .
4. Krenar Dila, atësia Mihal, amësia Olimbi, shtetas Shqiptar, lindur në Kolonjë, Kolonje, Shqipëri (ALB) dhe banues në Tiranë, me adresë Frederik shiroka; Nd. G V; H. 4; Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 07/08/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036244660 dhe nr. personal I50807046K .
5. Evisa Dila, atësia Enver, amësia Ermira, shtetase Shqiptare, lindur në Berat,Berat, Shqipëri (ALB) dhe banuese në Tiranë, me adresë Frederik shiroka; Nd. G V; H. 4; Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 15/10/1986, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032475268 dhe nr. personal I66015091L .
6. Nertila Meta, atësia Qemal, amësia Saime, shtetase Shqiptare, lindur në Librazhd, Librazhd, Shqipëri (ALB) dhe banuese në Tiranë, me adresë Brigada VIII; Nd. Pall.13; ; ; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia bashkiake nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 23/11/1984, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035546072 dhe nr. personal I46123023T .
7. Mimoza Canaj, atësia Jonuz, amësia Race, shtetase Shqiptare, lindur në Grizhe, Shkoder, Shqipëri (ALB) dhe banuese në SHKODËR, me adresë BALSHAJ 03310455; Nd. 11; H. 14; Ap. 1; SHKODËR; SHKODËR; 4001; SHKODËR, lindur më 22/06/1968, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034001613 dhe nr. personal G85622062D .
8. Luljeta Liçaj, atësia Orhan, amësia Haxhire, shtetase Shqiptare, lindur në Zhepovë, Përmet, Shqipëri

Fq. 1



(ALB) dhe banuese në Tiranë, me adresë ismail qemali 2/84; Nd. 1814; H. 0; Ap. 007; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 10/08/1966, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034803774 dhe nr. personal G65810090V.

9. Erjon Këri, atësia Sokrat, amësia Valentina, shtetas Shqiptar, lindur në Berat, Berat, Shqipëri (ALB) dhe banues në Tiranë, me adresë Brigada VIII; Nd. Pall.13; ; ; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia bashkiake nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 03/02/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035930848 dhe nr. personal I40203071V.

**BLERES: Shoqëria D E L T A**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K13127202W, me adresë Autostrada Tirane Durres, Godina DELTA, KM 30, përfaqësuar nga Administratori Luan Muça, atësia Shahin, amësia Kadire, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan, Elbasan, Shqipëri (ALB) dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Elbasan; Nd. .; ; ; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia bashkiake nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 05/08/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID me nr. personal H10805062A.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të aksioneve të Shoqërisë "55 INVEST" SHA., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

#### OBJEKTI:

Shitja e 6734(gjashtëmije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksioneve të shoqërisë "55 INVEST" sh.a që përfaqësojnë 25% (njëzet e pesë) të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari Z. Shpëtim Licaj dhe blerja e tyre nga shoqëria "DELTA" sh.a

Shitja 6734 (gjashtëmije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksioneve të shoqërisë "55 INVEST" sh.a që përfaqësojnë 25% (njëzet e pesë) të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari Z. Edjon Hila dhe blerja e tyre nga shoqëria "DELTA" sh.a

Shitja 6734 (gjashtëmije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksioneve të shoqërisë "55 INVEST" sh.a që përfaqësojnë 25% (njëzet e pesë) të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari Samir Canaj dhe blerja e tyre nga shoqëria "DELTA" sh.a

Shitja e 3367 (tremije e treqind e gjashtëdhjetë e shtate) aksioneve të shoqërisë "55 INVEST" sh.a që përfaqësojnë 12.5% (dymbëdhjetë pike pese) të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari Krenar Dila dhe blerja e tyre nga shoqëria "DELTA" sh.a

Shitja e 3367 (tremije e treqind e gjashtë e shtate) aksioneve të shoqërisë "55 INVEST" sh.a që përfaqësojnë 12.5% (dymbëdhjetë pike pese) të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari Erion Keri dhe blerja e tyre nga shoqëria "DELTA" sh.a

#### Kushtet Paraprake:

1. Shoqëria "55 INVEST" sh.a me NUIS L81828023Q është një shoqëri aksionare e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, e regjistruar pranë Q.K.B me datën 28.06.2018.
2. Shtësi Z. Shpëtim Licaj zotëron 6734(gjashtëmije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksione të shoqërisë

Fq. 2



- “55 INVEST”sh.a që përfaqësojnë 25% të kapitalit të saj, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.
3. Shitësi Z. Edjon Hila zotëron 6734(gjashtemije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksione të shoqërisë “55 INVEST”sh.a që përfaqësojnë 25% të kapitalit të saj, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.
  4. Shitësi Samir Canaj zotëron 6734(gjashtemije e shtateqind e tridhjetë e kater) aksione të shoqërisë “55 INVEST”sh.a që përfaqësojnë 25% të kapitalit të saj, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.
  5. Shitësi Krenar Dila zotëron 3367 (tremije e treqind e gjashtedhjetë e shtate ) aksione të shoqërisë “55 INVEST”sh.a që përfaqësojnë 12.5% të kapitalit të saj, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.
  6. Shitësi 3367 (tremije e treqind e gjashtedhjetë e shtate ) aksione të shoqërisë “55 INVEST”sh.a që përfaqësojnë 12.5% të kapitalit të saj, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.
  7. Aksionerët janë të interesuar që të gjithë paketën e aksioneve të tyre t’ia shesin vetëm Blerësit shoqëria “DELTA” sh.a duke u bërë kjo e fundit pronar i tyre menjëherë me likuidimin e cmimit të plotë të kontratës.
  8. Aksionerët, parapakisht, heqin dorë nga e drejta e parablerjes sipas parashikimit të nenit 8, pika 3 të Statutit të shoqërisë “55 INVEST”sh.a.
  9. Blerësi është i interesuar që të blejë të gjitha paketat e aksioneve të mësipërme, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë dhe të bëhet akionar i vetëm i shoqërisë “55 INVEST” sh.a.

### Neni 1 Objekti

Objekt të kësaj kontrate është transferimi me kundërshtpërbllim i të gjitha aksioneve nga Shitësi tek Blerësi, duke u kthyer ky i fundit në akionar të vetëm i shoqërisë “55 INVEST” sh.a.

### Neni 2 Çmimi i shitjes së aksioneve, mënyra dhe koha pagesës.

- 2.1. Të gjitha aksioneve, në total 26.937, palët iu kanë caktuar vlerën prej 2,190,000 (dy milionë njeqind e nentëdhjetë mijë) euro. Pra, 81.300813 euro për aksion.
- 2.2. Aksionerët me 6734 (gjashtemije e shtateqind e tridhjetë e kater ) aksione do të paguhet me nje vlerë prej 547,500 (pesëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind ) euro, që përbën çmimin e shitblerjes që do t’i paguhet secilit prej tyre. Aksionerët me 3367 aksione do të paguhet me nje vlerë prej 273,750 (dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë ) euro, që përbën çmimin shitblerjes që do t’i paguhet secilit prej tyre.
- 2.3. Pagesa e çmimit do të bëhet në rrugë bankare në numrat e llogarive të secilit prej akionarëve në mënyrën sic vijon:
  - shuma prej 200,000 (dyqind mijë) euro në total do të depozitohet në llogari bankare te secilit akionar, sipas përqindjes së kapitalit që ata zotërojnë, menjëherë pas nënshkrimit e kësaj kontrate. Aksionerët me 25 (njëzet e pesë) përqind të aksioneve do të kreditohen me 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro ndërsa aksionerët me 12,50 (dymbëdhjetë pikë pesëdhjetë) përqind do të kreditohen me 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro secili.
  - pjesa e mbetur e çmimit prej 1,990,000 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mije) euro do të depozitohet në bankë me afat maksimal deri në datën 20.12.2020, per te gjithë shitesit, e ndarë në përpjestim me përqindjen e aksioneve për secilin prej tyre.

### Neni 3 Mënyra e kalimit të pronësisë së aksioneve

Me likuidimin total te çmimit prej 2,190,000 euro (dymilion e njeqind e nentëdhjetë mije euro) dhe



mbërritjen e shumës në llogarinë e secilit Shites në përpjestim me numrin e aksioneve të provuar me mandat bankar, secili prej tyre zhvishet automatikisht nga e drejta e pronësisë mbi të gjithë paketën e aksioneve që zotërojnë tek shoqëria "55 INVEST" sh.a dhe Blerësi bëhet aksionar i vetëm duke zotëruar 26.937 (njetzet e gjashtëmijë e nentëqind e tridhjetë e shtate) aksione që përfaqësojnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie dhe të gjithë asetëve.

#### Neni 4 Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

4.1. Secili prej shitësave është pronari, përfutuesi i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve në shitje, deklarojnë dhe garantojnë se janë pronarë dhe përfutues të vetëm dhe të ligjshëm të gjitha aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë "55 INVEST" sh.a në një total prej 26.937 (njetzet e gjashtëmijë e nentëqind e tridhjetë e shtate) aksione.

4.2. Aksionet në shitje janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar aksionet.

4.3. Pala shitëse deklaron se asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë lidhur me ndonjë nga aksionet në shitje ose aksionet e shoqërisë "55 INVEST" sh.a.

4.4. Secili prej Shitësave deklaron dhe garanton Blerësin se deri në momentin e likuidimit total të vlerës së kontratës nuk do të transferojë pjesërisht apo tërësisht aksionet të të tretët.

4.5. Pala shitëse deklaron dhe garanton nuk do të bëhet asnjë zmadhim/zvogëlim të kapitalit, ndryshime të Statutit apo Aktit të Themelimit që çënon interesat e Blerësit sipas kësaj kontrate.

4.6. Secili prej Shitësave deklaron dhe garanton Blerësin se deri në momentin e likuidimit total të vlerës së kontratës sipas afatit të përcaktuar deri më 20.12.2020 ata nuk do të kryejnë asnjë veprim të parashikuar nga ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, që lidhet me cdo të drejtë, edhe me të drejtën e votës.

4.7. Po ashtu, deri në momentin e likuidimit total të vlerës së kontratës Asambleja e Përgjithshme dhe Keshilli Mbiqyqyres i shoqërisë "55 INVEST" sh.a nuk do të kryejnë asnjë veprim ligjor apo të marrin vendime që bëhen pengesë për ekzekutimin e kësaj kontrate.

4.8. Shitësit deklarojnë se nuk do të kryejnë asnjë veprim për shitjen e asetve të shoqërisë deri në momentin e likuidimit total të vlerës së kontratës me afat deri në datën 20.12.2020 të dakordësuar me sipër.

4.9. Shitësit garantojnë se shoqëria "55 INVEST" sh.a nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje siguruese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

4.10. Shitësi deklaron se nuk ka asnjë proces gjyqësor civil, penal, apo administrativ dhe as në ngarkim të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë me objekt aksionet e tij. Nuk ka asnjë detyrim tatimor apo gjyba për të shlyer.

4.11. Shitësi, menjëherë pas likuidimit total të vlerës së kontratës nga Blerësi :

do të dorëzojë certifikatat që përfaqësojnë aksionet në shitje, të cilat duhet të jenë lëshuar dhe përgatitur para datës së kryerjes së pagesës, të nënshkruara rregullisht në favor të Blerësit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar;

do të nënshkruajë dhe dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, në mënyrë që t'i kalojë Blerësit një titull të mirë dhe të rregullshëm mbi aksionet në shitje dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj kontrate,





përfshirë noterizimin e saj;

do të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, administratorit, të ekspertëve kontabël të Shoqërisë "55 INVEST" sh.a nëpërmjet paraqitjes së letrave të dorëheqjes së tyre pranë Blerësit dhe të caktojë në pozicionet e tyre personat e propozuar nga Blerësi.

4.12 Shitësit do të mbajnë të pacënuar Blerësin për çdo detyrim tatimor të paparashikueshëm që rrjedh nga akte, fakte ose mosveprime të ndodhura para nënshkrimit të kontratës dhe pagimit të cmimit të plotë të saj.

4.13 Shitësit do të mbajnë të pacënuar Blerësin nga çdo dhe të gjitha pretendimet e bëra nga palët e treta, si për shembull por jo në mënyrë shteruese: shumat e detyrueshme për palët e treta në përgjithësi për çdo titull ose arsye dhe çdo detyrim tjetër.

4.14 Secili aksioner është përgjegjës solidar me pasurinë e tij personale për çdo detyrim të fshehur tatimor, detyrime ndaj të tretëve që mund të ketë shoqëria "55 INVEST" sh.a, ose dëme që lindin nga veprimet e tij deri në datën e nënshkrimit të kontratës dhe pagimit të cmimit të plotë të saj.

#### Neni 5 Deklarimet dhe garancitë e Blerësit

5.1. Blerësi garanton Shitësin se ka të gjithë autorizimin për të nënshkruar këtë kontratë, nuk është në gjendje paaftësie paguese, dhe ka kompetenca dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e tij.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se do të tregojë përgjegjshmëri të plotë për shlyerjen e çmimit të plotë të parashikuar në këtë kontratë prej 2.190.000 (dy milionë e njëqind e nentëdhjetë mijë) euro.

#### Neni 6 Regjistrimi i kontratës

Kjo kontratë, menjëherë pas nënshkrimit të saj, do të regjistrohet nga administratori i shoqërisë "55 INVEST" sh.a në regjistrin e aksioneve të shoqërisë dhe në Regjistrin Tregëtar në përputhje me nenin 8 të Statutit dhe 119 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pa të drejtën dhe detyrimin për të kryer ndryshime në ekstraktin tregtar.

#### Neni 7 Forca madhore

7.1. Mospërbushja e detyrimeve sipas kësaj kontrate prej njëres nga Palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërbushje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur për këtë ngjarje.

7.2. Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo Palë, nuk mund të kryejë këtë veprim për shkak të forcës madhore.

#### Neni 8 Penalitete

8.1 Zgjidhja e njëanëshme e kontratës nga njëra palë, automatikisht e detyron këtë të fundit të dëmshpërblejë palën tjetër në vlerë monetare me dyfishin e cmimit të plotë të kësaj kontrate të përcaktuar në nenin 2.1.



8.2 Në rast të zgjidhjes së kontratës nga pala shitëse, kjo e fundit, përveç penaltetit duhet të kthejë edhe shumën prej 200,000 (dyqind mijë) euro që i është kredituar asaj sipas nenit 2.3 të kësaj kontrate.

#### Neni 9 Përfundimi i kontratës

9.1 Me pagimin e plotë të çmimit të blerjes sipas përcaktimeve të nenit 2, kjo kontratë konsiderohet e përfunduar me sukses.

9.2 Nëpërmjet një deklarate noteriale të njëanshëme, bashkëngjitur mandat pagesat bankare, pa nevojën e konfirmimit nga Shitësi, Blerësi mund të paraqitet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) për të kryer procedurën e ndryshimeve në ekstraktin tregëtar lidhje me aksioneret e shoqërisë "55 INVEST" sh.a.

9.3 Në qoftë se çmimi i plotë i kontratës nuk është paguar sipas nenit 2 të kësaj kontrate, Shitësi, pa nevojën e konfirmimit nga Blerësi, nëpërmjet një deklarate të njëanshëme noteriale i drejtohet Q.K.B për të bërë çregjistrimin e kësaj kontrate se shitblerje të regjistruar sipas nenit 6.

#### Neni 10 Zgjidhja e Kontratës

Kjo kontratë mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, duke i kthyer palët në gjendjen fillestare siç ishin para nënshkrimit të kësaj kontrate.

#### Neni 11 Interpretimi i kontratës

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve që i ka shtyrë për nënshkrimin e aktit.

#### Neni 12 Njoftimet

12.1 Çdo njoftim mbi ekzekutimin e kësaj kontrate, pretendime të tjera apo edhe zgjidhjen e saj, do të njoftohet me shkrim.

12.2 Njoftimet për Shitësin do të kryhen me postë të regjistruar në adresë:

Z.Shpëtim Licaj

Adresë: Rruga "Ismail Qemali, pas Piceri Era ,P.7, Ap 10",Tiranë

E-Mail: elidon\_licaj@yahoo.it

Telefon: 0682013624

Z. Edjon Hila

Adrese: Vaudejës, me adresë Bri Mali; Nd. Nder.60; ; Bushat; Barbullush

Samir Canaj ,

Adresë: Malësi e Madhe, Lagjja Gjormë, Rruga Shkodër Koplik, godinë 1-katëshe, nr.pasurie 1063/32, zona kadastrale 1766

E-Mail: info@canaj.al

Telefon: 0682026021

Krenar Dila

Adresë : Frederik shiroka; Nd. G V; H. 4; Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 7;



Erjon Keri

Adresë : Brigada VIII; Nd. Pall.13; ; ; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia bashkiake nr. 5; 1019

12.3. Njoftimet për Blerësin do të kryhen me postë të regjistruar në adresë;

Adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Godina DELTA, Km 30

Secila palë kontraktore ka detyrimin që të njoftojë tjetrën për çdo ndryshim të dhënave të adresës së saj, në të kundërt nuk ka vend për përgjegjësi kundrejt palës tjetër. Në rast se nuk përmbushet ky detyrim, pala që ka kryer njoftimin konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin

Neni 13 Llogaritë bankare

13.1 Palët kontraktore deklarojnë se pagesa e cmimit të kontratës pranohet të kryhet në llogaritë e mëposhtëme:

Për Z.Shpëtim Licaj çmimi i kontratës do të depozitohet në numrin e llogarisë bankare prane ABI BANK SHA: AL8321021080000000000181600;

Për Z.Edjon Hila çmimi i kontratës do të depozitohet në numrin e llogarisë bankare prane Credins Bank me IBAN AL32212510810000000001411998.

Për Samir Canaj çmimi i kontratës do të depozitohet në numrin e llogarisë bankareprane OTP ALBANIA BANK SHA : AL62213520100000000001248079.

Për Krenar Dila çmimi i kontratës do të depozitohet në numrin e llogarisë bankare prane Procredit Bank sha AL61209110810000080427960202

Për Erion Keri çmimi i kontratës do të depozitohet në numrin e llogarisë bankare prane Procredit Bank sha AL63209110810000080054470202.

Neni 14 Dispozitat e fundit

Bashkëngjitur kësaj kontratë , si pjesë e pandarë e saj janë aktet e mëposhtëme:

- ID të palëve nënshkruese
- Ekstraktet e Q.K.B për shoqëritë;
- Vendimin e shoqërisë "DELTA" sh.a per lidhjen e kësaj kontrate;
- Vendimi i shoqërisë "55 INVEST" sh.a per lidhjen e kesaj kontrate

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.





Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËTKONTRAKTUESE**

**SHITES**

Shpëtim Liçaj

*Shpëtim Liçaj*

Samir Canaj

*Samir Canaj*

Edjon Hila

*Edjon Hila*

Krenar Dila

*Krenar Dila*

Evisa Dila

*Evisa Dila*

Nertila Meta

*Nertila Meta*

Mimoza Canaj

*Mimoza Canaj*

Luljeta Liçaj

*Luljeta Liçaj*

Erjon Këri

*Erjon Këri*

**BLERES**

SHOQERIA "DELTA" SHA

Perfaqesuar nga administratori:  
**LUAN MUÇA**

*Luana Muca*

**NOTERE  
MIMOZA SADUSHAJ**



*Mimoza Sadushaj*

---

**REZULTATET E KËRKIMIT**

---

Numri i Rezultatit të Kërkimit:	D-20200911135848257
Data e Rezultatit të Kërkimit:	11.09.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit:	1:58:48PM
Lloji i Kërkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-219-665
Referenca e Përdoruesit:	

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

55 INVEST SH.A.



*Niside Fegu*